

## UDHËZUES

### **PËR PËRDORIMIN E LIBRIT TË TRANSPARENCËS Matura Shtetërore 2017**

Libri i Transparencës përbën një dokument mjaft të rëndësishëm për transparencën e procesit të Maturës Shtetërore dhe vihet në shërbim të të gjithë maurantëve/ kandidatëve që dëshirojnë të studiojnë në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL).

Libri i Transparencës plotëson kuadrin e informimit të saktë dhe të drejtë, dukuri që përshkon të gjithë procesin e Maturës Shtetërore dhe të regjistrimeve në IAL.

Tashmë të gjithë maurantët/kandidatët e shkollave të mesme të Republikës, kanë marrë rezultatet e të katër/pesë provimeve të Maturës Shtetërore. Tek Libri i Transparencës, çdo maurant/ kandidat gjen të gjithë treguesit e rezultateve të përfundimit të shkollës së mesme dhe provimeve të Maturës Shtetërore:

1. Notën e përgjithshme mesatare të viteve të shkollimit të mesëm sipas VKM-së nr. 346 dt. 19.04.2017, plus provimet e MSH
2. Rezultatin e provimit të Letërsisë
3. Rezultatin e provimit të Matematikës
4. Rezultatin e provimit të Gjuhës së Huaj
5. Rezultatet e të dy provimeve të lëndëve me zgjedhje të detyruar

Gjithashtu aty ai gjen dhe preferencat e përzgjedhura prej tij në Formularin e Aplikimit në IAL, për programet e studimit, që ofrojnë IAL-të për vitin akademik 2017-2018.

Libri i Transparencës, do të përmbajë të dhënat e maurantëve / kandidatëve të çdo shkolle të vendit. Libri i Transparencës i seleksionuar për çdo shkollë do t'u shpërndahet DAR/ZA-ve përkatëse. Për çdo shkollë janë renditur vetëm maurantët e saj, të cilët kanë rezultuar kalues në të gjitha provimet e Maturës Shtetërore dhe kanë aplikuar online me formularin e aplikimit në IAL.

**Nuk përfshihen në Librin e Transparencës, maurantët që nuk kanë kaluar qoftë edhe në njërin prej pesë provimeve, pra janë vlerësuar me notën 4 (katër).**

Secili kandidat maurant ka hapësirën e tij në Librin e Transparencës, ku në rreshtin e parë jepen: Numri rendor; numri identifikues i maurantit (ID), që e ka shoqëruar gjatë gjithë procesit të Maturës Shtetërore;

Në pjesën majtas poshtë janë emërtesat dhe notat e shkallëzuara të 6 elementeve vlerësues të Maturës Shtetërore.

Më tej vijohet me preferencat e kandidatit, të renditura siç janë përzgjedhur prej tij në Formularin e Aplikimit në IAL. Preferencat përmbajnë kodin (ID) e programit të studimit, emërtesën e programit të studimit.

Në librin e transparencës nuk paraqiten gjeneralitetet e maurantit/kandidatit (emri, atësia, mbiemri dhe ditëlindja) me qëllim që të mbrohen të dhënat e tij personale.

Libri i transparencës publikohet në Web Siten e QSHA ose MAS.

Libri i Transparencës është një libër pune, ku secili maurant/kandidat mund të kontestojë me anë të **Formularit të Korrigjimit të Pasaktësive**, ndonjë parregullsi që vëren në të dhënat e tij në **Librin e Transparencës**. Për çdo ndryshim, do të kërkohet dokumentim zyrtar nga Drejtoritë e Shkollave dhe Drejtoritë Arsimore të rretheve (shih **Formularin e Korrigjimit të Pasaktësive**).

Ju urojmë suksese

**Qendra e Shërbimeve Arsimore**